VENDIM
Nr. 855, datë 4.12.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ALLKAJ TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Allkaj të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 227 (dyqind e njëzet e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Allkaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Allkaj Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
6	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive kulturore	Në pronësi
8-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
11-13, 15-23, 27, 33, 197-218	Infrastrukturë (troje, rrugë vendore)	Në pronësi
31, 39	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
40-44	Shërbim funeral	Në pronësi
45-81	Mbrojtje civile	Në pronësi
174, 177, 179, 181, 184, 187, 189, 192	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
96, 112, 134, 147, 156, 163, 172, 175, 176, 178, 180, 182, 183, 185, 186, 188, 190, 191, 193	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi